

# “NDRYSHIMI I LIGJIT TË BUXHETIT PËRMES AKTEVE NORMATIVE TË QEVERISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Skenderbe Sadikaj

## Abstrakti

Republika e Shqipërisë i ka njohur ekzekutivit mundësinë që përmes akteve normative me fuqinë e ligjit të ndryshojë ligjin për buxhetin e shtetit, në raste të nevojës dhe urgjencës, duke kërkuar kështu vetëm miratimin nga ana e Kuvendit, i cili është organi që shndërron aktin normativ me fuqinë e ligjit në ligj, ndonëse hyrja në fuqi e tij është që nga momenti i miratimit nga Këshilli i Ministrave. Eksperienca e shtetit shqiptar, e gërshtuar edhe me praktikën e shteteve të tjera të cilat po ashtu i njohin këtë të drejtë ekzekutivit të tyre, siguron se instrumenti legjislativ i dhënë në dorë të ekzekutivit nuk cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Sikurse çdo shtet edhe Republika e Kosovës përballet me situata të ndryshme ekonomike e politike të cilat shkaktojnë efekte dhe pasoja në buxhetin e saj, e të cilat jo gjithnjë janë të parashikueshme e jo gjithnjë mund të zgjidhen pa shkaktuar më shumë pasoja nga ndërhyrjet në ligjin për buxhetin, nëpërmjet procedurës së zakonshme parlamentare për ndryshimin e ligjit për buxhet. Situatat e jashtëzakonshme, ato të emergjencës, të cilat shfaqen në një situatë nevojë dhe urgjence, për të cilën ndërhyrja rregullatore kërkon në mënyrë të pashmangshme fuqinë juridike ligjore, arsyetojnë nevojën që ekzekutivit ti jepet në kompetencë një instrument legjislativ, i cili në vende të ndryshme njihet si dekretligj apo akt normativ me fuqinë e ligjit. Lejimi i pushtetit ekzekutiv të ushtrojë në mënyrë përjashtuese kompetenca legjislative është praktikë e njohur në shumë vende në Evropë por edhe në sisteme të tjera demokratike në Botë. Mos njohja e kësaj të drejte në Kosovë nuk ka qenë më parë objekt shqyrtimi politik, juridik apo shkencor, ndonëse në praktikë jo rrallë ka pasur situata të nevojës dhe urgjencës, të cilat kanë kërkuar akte rregullatore me fuqinë e ligjit, e për të cilat është pritur procedura parlamentare, e cila jo gjithnjë ka arritur të jetë e efektshme në kohë për të rregulluar çështjen konkrete. Prandaj, shqyrtimi i një shteti specifik sikurse është Shqipëria, por edhe krahasimi me shtete të tjera, konsiderohen të rëndësishme për të hapur rrugë një diskutimi i cili në një të ardhme të caktuar mund të sjellë ndryshime kushtetuese e ligjore që do të njohin Qeverisë së Republikës së Kosovës mundësinë që përmes akteve qeveritare të ndryshojë ligjin për buxhetin.

**Fjalë kyçe: pushteti ekzekutiv, pushteti legjislativ, buxheti i shtetit, aktet normative, ligji, ekonomia.**